

MBROJTJET NGA INAIL

Nëse **INAIL** e njeh aksidentin në punë ose sëmundjen profesionale, ke të drejtë të përfitosh një **kompensim ekonomik**, i cili ndryshon në bazë të shkallës së dëmtimit:

DËMTIM BIOLOGJIK

(Pasojat nga 6% deri në 15%)

Ke të drejtë për një **kompensim në para, njëherësh**, në varësi të përqindjes së dëmtimit dhe moshës tënde.

PENSION I PËRJETSHËM

(Pasojat nga 16% deri në 100%)

Ke të drejtë për një **pagesë mujore**, e cila **rivalorizohet çdo vit**, në bazë të përqindjes së dëmtimit dhe pagës tënde.

PASI TË KESH ARRITUR NJOHJEN NGA INAIL ?

RISHIKIMI / PËRKEQËSIMI

AKSIDENTI

Mund të kërkojsh për **përkeqësim** të gjendjes deri në **10 vjet nga ngjarja** – një herë në vit për **4 vitet e para**, më pas në vitin e **7-të** dhe në vitin e **10-të**.

SËMUNDJA PROFESIONALE

Mund të kërkojsh për **përkeqësim** deri në **15 vjet nga denoncimi**.



INCA CGIL është pranë teje për njohjen e të drejtave tua.

Mund të shkruash në adresën:
infortuni@inca.it

ADRESA:

Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës, Kati 1, Nr. 29, Tiranë



Duke punuar mund të SËMUREMI



Nëse mendon se ke probleme shëndetësore të shkaktuara nga puna jote, vjen në **Patronatin INCA CGIL** dhe do të mund të marrësh njohjen e të **DREJTAVE TUAJA**.

Në rast aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale, **INCA CGIL është me ty**.



SËMUNDJET PROFESIONALE

Një sëmundje konsiderohet profesionale nëse ajo është marrë gjatë ushtrimit të punës dhe për shkak të punës.

RREZIQET që ndodhen në ambientet e punës, me kalimin e kohës, mund të shkaktojnë:

- **DËMTIME NË SISTEMIN MUSKULOR DHE KOCKOR**

Lëvizje të përsëritura, ngritje manuale të ngarkesave, mbingarkesë e gjymtyrëve të sipërme, dridhje, qëndrime të gabuara etj.

- **TUMORE PROFESIONALE**

Produktet kimike dhe agjentët fizikë, pluhurat e drurit dhe lëkurës, rrezet e diellit, pesticidet, preparatet bimore, rrezatimet jonizuese etj., paraqesin një rrezik për shëndetin e punëtorëve dhe punëtorëve



- **STRESI I LIDHUR ME PUNËN**

Ritmi dhe organizimi i punës, kushtet e ambientit, konfliktet dhe presionet mund të shkaktojnë stres, si dhe shfaqjen e shqetësimeve të ankthit, pagjumësisë dhe ndjenjës së paaftësisë.

Nëse mendon se problemi yt shëndetësor është shkaktuar nga puna, në INCA do të gjesh personel të kualifikuar dhe mjekë që mund të vlerësojnë rastin tënd dhe të nisën procedurën për **njohjen e sëmundjes profesionale**.



AKSIDENT NË PUNË

- Nëse lëndohesh ndërsa je duke punuar, **është aksident gjatë punës**.
- Nëse ke një aksident rrugor gjatë rrugës nga shtëpia për në punë, nga puna për në shtëpi, ose kur lëviz nga një vend pune në një tjetër, është **aksident në itinerar**.
- Nëse ndihesh keq duke punuar në temperatura të larta, qoftë jashtë në diell apo në ambiente të mbyllura, **është aksident nga nxehtësia**.

Në të gjitha këto raste, është e rëndësishme të shkosh menjëherë në një zyrë të INCA CGIL me dokumentacionin që të ka dhënë Urgjenca.